



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture,
Forestry and Rural Development

DIVIZIONI PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/DIVIZIJA ZA JAVNO
KOMUNICIRANJE/DIVISION OF PUBLIC COMMUNICATION

SHPALLJE PUBLIKE

Për mbështetje financiare për organizatat dhe shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të produkteve bujqësore dhe agro-ushqimore

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të mbështesë Organizatat dhe Shoqatat e Prodhuesve, Përpunuesve të Produkteve Bujqësore dhe Agro-ushqimore vendore, vetëm në një projekt brenda vitit kalendarik, sipas Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Kritereve Mbështetëse për Organizatat dhe Shoqatat e Prodhuesve dhe Përpunuesve të Produkteve Bujqësore dhe Agro-ushqimore.

Aplikuesit mund të aplikojnë për realizimin e aktiviteteve në bujqësi dhe zhvillim rural, si:

- Trajnime;
- Këshilla;
- Kampanje informative, tryeza, seminare, punëtori;
- Promovime, ekspozita, panaire;
- Aktivitete të karakterit garues;
- Ditë fushore.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar; (*mund ta shkarkoni në uebfaqen e Ministrisë apo mund ta merrni fizikisht në zyrën përkatëse të aplikimit*)
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhirologarinë bankare të aplikuesit;
- Projekt propozimin/planin e biznesit;
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Certifikatën e TVSH-së;
- Certifikata e Numrit Fiskal, dhe
- CV të ekspertëve.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë **15 ditë** kalendarike dhe fillon prej datës **1 Mars 2017 deri më 15 Mars 2017**.

Mënyra e aplikimit:

- Të gjithë aplikuesit fillimisht gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për aplikim, i cili është parakusht për përfitim të mbështetjes.
- Gjatë procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit dhe kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të zbatohen masat ndëshkimore, duke u sanksionuar sipas nenit 38 Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27.07.2009) dhe nenit 38 A Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 26/16 Tetor 2012).

Vendi i dorëzimit:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Sheshi "Nëna Terezë", Zyra Nr.: 242 (Arkiva)

Vërejtje:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet i kompletuar dhe në dy (2) kopje, brenda periudhës kohore të aplikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

JAVNO OBAVEŠTENJE**Za finansijsku podršku za organizacije i udruženja proizvođača i prerađivača poljoprivrednih i agro-prehrambenih proizvoda**

Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja podržaće organizacije i udruženja proizvođača, prerađivača domaćih poljoprivrednih i agro-oprehrambenih proizvoda, samo u jednom projektu tokom jedne kalendarske godine, shodno administrativnom uputstvu za određivanje podržnih kriterijuma za organizacije i udruženja proizvođača, prerađivača domaćih poljoprivrednih i agro-oprehrambenih proizvoda.

Aplikanti mogu aplicirati za realizaciju aktivnosti u poljoprivredi i ruralnom razvoju, kao što su:

- Obuke;
- Savetovanje;
- Informativne kampanje, okrugli stolovi, seminari, radionice;
- Promocije, izložbe, sajmovi;
- Aktivnosti takmičarskog karaktera;
- Terenski dani.

Dokumentacija neophodna za apliciranje:

- Popunjena aplikacija; (*možete se preuzeti sa veb stranice Ministarstva ili lično u odgovarajućoj kancelariji za apliciranje*);
- Kopija lične karte Republike Kosova;
- Potvrda banke o bankarskom žiro računu aplikanta;
- Predlog projekta/poslovni plan;
- Uverenje o registraciji NVO-a;
- Uverenje o registraciji poslovanja za pravna lica;
- Uverenje o PDV-u;
- Uverenje o fiskalnom broju; i
- CV stručnjaka.

Period za apliciranje:

Apliciranje traje kalendarskih **15 dana** i počinje od **1 Mart 2017 do 15 Mart 2017**.

Način apliciranja:

- Svi aplikanti su prvenstveno tokom apliciranja obavezni da popune obrazac za apliciranje, koji je i preduslov za dobijanje podrške.
- Tokom procedure razmatranja dokumentacije i provere, u slučaju nepravilnosti, primenjuju se kaznene mere, vršenjem sankcija shodno članu 38 zakona br. 03/L-098 za poljoprivredu i ruralni razvoj (službeni glasnik Republike Kosova br. 56/27.07.2009) i člana 38 A zakona br. 04/L-090 o izmeni i dopuni zakona br. 03/L-098 za poljoprivredu i ruralni razvoj (službeni glasnik Republike Kosova br. 26/16 oktobar 2012).

Mesto podnošenja:

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja – Trg. "Nëna Terezë", kancelarija br.: 242 (arhiva).

Napomena:

- Dokumentacija za apliciranje se treba podneti upotpunjena i to u dve (2) kopije u toku predviđenog roka za apliciranje.
- Dokumentacija koja se podnese nakon objavljenog roka, neće biti primljena na razmatranje.